



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 30  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S - 2  
Prishtinë, më 4 maj 2016, në orën 13:00

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË**  
**DHE MIRËQENIE SOCIALE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Flora Brovina, Fikrim Damka, Hatim Baxhaku, Fadil Beka, Adem Hoxha dhe Mirjeta Kalludra.

**Munguan:** Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Shpetim Kalludra –MPMS, Fisnik Lakna – MPMS, Sanije Berisha – OSBE dhe Fjolla Uka – KDI.

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

**Mbledhjen e kryesoi,** Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**RENDI DITËS:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së datës: 5.04.2016 dhe 20.04.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënëseve;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
5. Të ndryshme.

*Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

*Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.*

**2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së datës: 5.04.2016 dhe 20.04.2016;**

**Kryetarja,** konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalet e mbledhjes së Komisionit, të mbajtura më 05.04.2016 dhe 20.04.2016, pa vërejtje.

**3. Shqyrtimi i Projektligjit për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve;**

**Kryetarja,** vazhdojmë me piken e tretë, para jush keni propozim amendamentet e grupit punues të cilin e falënderojmë për punën që ka bërë për këtë projektligj. Vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin e amendamenteve një nga një dhe në fund i miratojmë amendamentet komplet dhe i procedojmë me tej.

**Fadil Beka – kryetar i grupit punues** -faleminderit kryetare, ne si grup punues kemi mbajtur disa takime dhe bashkërisht kemi bërë disa propozim amendamente, po ashtu kemi pas propozime edhe për ndryshimin e emrit të projektligjit ku para nesh kemi tri propozime. Vazhdojmë ashtu siç thatë edhe ju me miratimin e propozim amendamenteve një nga një.

**Komisioni,** pas prezantimit dhe diskutimit miratoj amendamentet një nga një, gjithë deputetet njëzëri miratuan raportin me amendamentet, komisioni nxori këtë:

**Përfundim**

Të procedohet me tej për shqyrtim në katër komisionet e përhershme raporti me amendamentet e miratuara për projektligjin për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve.

*Amendamentet e projektligjit për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve, të miratuara në komision:*

**Amendamenti 1**

Titulli i Projektligjit të riformulohet si vijon: **LIGJI PËR REGJISTRIMIN DHE OFRIMIN E SHËRBIMEVE PËR TË PAPUNËT, PUNËKËRKUESIT DHE PUNËDHËNËSIT**

**Amendamenti 2**

Neni 1. i Projektligjit riformulohet si vijon:

Qëllimi i këtij ligji është që të rregullohen kushtet dhe procedurat e regjistrimit të të papunësuarve, punëkërkesve dhe punëdhënësve, ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësim nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës në tekstin e mëtejme (APRK) dhe detyrimet e tyre ndaj APRK, për të marrë këto shërbime që kanë synim rritjen e punësimit dhe parandalimin e papunësisë afatgjatë në Republikën e Kosovës.

### **Amendamenti 3**

Neni 2, i Projektligjit riformulohet si vijon:

Dispozitat e këtij ligji zbatohen nga APRK, ndaj të papunësuarve, punëkërkesve dhe punëdhënësve të regjistruar.

### **Amendamenti 4**

Në tërë tekstin e Projektligjit fjala „ shumëkanalësh” zëvendësohet me fjalën „sistemin e shërbimeve online“.

### **Amendamenti 5**

Në nenin 3, riformulohet si vijon:

## **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

**1.1. I papunësuar i regjistruar** - çdo person i moshës prej tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetekatër (64) vjeç, i papunësuar dhe i regjistruar në APRK;

**1.2. Punëkërkesi i regjistruar** – çdo person që kërkon punë prej moshës pesëmbëdhjetë (15) deri tetëmbëdhjetë (18) vjeçare , personat që punojnë me orar të plotë apo gjysmë orari, personat që janë suspenduar përkohësisht nga puna, të cilët janë të regjistruar në sistemin e shërbimeve online të APRK;

**1.3. Punëdhënësi i regjistruar** - personi fizik ose juridik i cili i siguron punë punëmarrësit dhe i paguan pagën për punën ose për shërbimet e kryera, dhe i cili regjistrohet në Zyrën e Punësimit personalisht ose në sistemin e shërbimeve online të APRK;

**1.4. Deklarata e Papunësisë** - dokument zyrtar i Zyrës së Punësimit, përmes së cilës vërtetohet se personi është i papunë dhe në mënyrë aktive ka kërkuar punë;

**1.5. Aftësimi dhe riaftësimi profesional** - aktivitetet që kanë për qëllim të ofrojnë njohuri dhe shkathtësi praktike për realizim efikas të aktiviteteve në kuadër të një profesioni apo një grupi profesioneesh;

**1.6. Grupet e cenueshme** - personat e klasifikuar nga këshilltarët e punësimit që kanë më shumë vështirësi në gjetjen e punës, siç mund të janë të papunët nën njëzetepesë (25) vjeç, të papunët afatgjatë të regjistruar mbi dymbëdhjetë (12) muaj, të papunët pa kualifikime profesionale, të papunët me aftësi të kufizuara, dhe përfitues nga asistenca sociale, etj;

**1.7. Personat me aftësi të kufizuara** – persona që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afat-gjatë të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët;

**1.8. Punësimi i përshtatshëm** - çdo punë e cila është në përputhje me kushtet dhe kërkesat e dispozitave ligjore që e rregullojnë marrëdhënien e punës, punë të cilën e kryen personi në përputhje me aftësitë , mundësitë si dhe në përputhje me kualifikimin përkatës të fituar gjatë shkollimit, aftësimit apo riaftësimit profesional të tij;

**1.9. MPMS** - Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale;

**1.10. APRK** - Agjencia përkatëse për Punësim në Republikën e Kosovës;

**1.11. DPP** - Departamenti i Punës dhe Punësimit;

**1.12. ZP** - Zyra e Punësimit, si strukturë organizative e APRK;

**1.13. QAP** - Qendra e Aftësimit Profesional, si strukturë organizative e APRK-së;

**1.14. Sistemi i shërbimeve online** - ofrimi i shërbimeve të punësimit për klientët nga ana e APRK nëpërmjet internetit, e-mailit, telefonave etj;

**1.15. Plani individual i punësimit (PIP)** - plan që përgatitet për personin i cili është pjesë e grupit të cenueshëm, për të rritur mundësinë e tij për të gjetur punë;

**1.16. Klubi i punës** - është një program specifik i Shërbimeve Publike të Punësimit-SHPP, i cili i bashkon një grup individësh të papunësuar në baza të rregullta në mënyrë që të ofrohet mbështetja për të zhvilluar aftësitë e papunësuarve për të kërkuar dhe gjetur punë. Klubi ju mundëson anëtarëve që të zgjerojnë rrjetin e tyre të kontakteve, ofron mbështetje gjatë kërkimit të punës në grup dhe krijon vetëbesimin dhe optimizmin e pjesëmarrësve;

**1.17. Panairet e punës** - është një ngjarje që zhvillohet në zonë të caktuar disa herë në vit, ku një numër i punëdhënësve dhe punëkërkuesve vijnë së bashku për qëllime të aplikimit dhe intervistimit për punë;

## **Amendamenti 6**

Neni 4, i Projektligjit riformulohet si vijon:

1. Shërbimet e punësimit lehtësojnë punësimin e personave që kërkojnë punë dhe punëdhënësit në gjetjen e fuqisë së përshtatshme punëtore.

2. Zyrat e Punësimit gjatë ndërmjetësimit në punësim trajtojnë palët pa diskriminim në bazë të prejardhjes etnike, gjinisë, moshës, fesë, mendimit politik, ngjyrës, apo ndonjë formë tjetër të diskriminimit që rregullohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

3. APRK do të siguroj konfidencialitet në të gjitha aktivitetet dhe shërbimet e tyre.

4. Të gjitha shërbimet e ofruara për të papunët e regjistruar, punëkërkuessit e regjistruar dhe punëdhënësit e regjistruar janë pa pagesë.

### **Amendamenti 7**

Në neni 5, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Çdo i papunë ka të drejtë të regjistrohet në Zyrat e Punësimit, për të marrë shërbimet e punësimit, nëse i plotëson kushtet si vijon:

1.1. Nuk ka të regjistruar një subjekt tregtar apo subjekt tjetër juridik, ose nuk është bashkëpronar në ndonjë subjekt tregtar apo ndonjë subjekt tjetër juridik;

1.2. Nuk ka të regjistruar ndonjë fermë në regjistrin e fermave pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

1.3. Nuk është i pensionuar, ose i pensionuar parakohshëm;

1.4. Nuk është nxënës apo student i rregullt;

1.5. Në mënyrë aktive kërkon punë dhe është në dispozicion për punësim;

1.6. Është shtetas i Republikës së Kosovës dhe jeton në Kosovë, është shtetasi i huaj apo person pa shtetësi, nëse ka leje të qëndrimit në kohë të përkohshme ose të përhershme në Republikën e Kosovës,

1.7. Nuk është i regjistruar në Zyrën e Punësimit.

### **Amendamenti 8**

Në nenin 5, paragrafi 3, fshihet nën-paragrafi 3.2.

### **Amendamenti 9**

Në nenin 5, paragrafi 4 riformulohet në 2 paragraf si vijon:

4. Zyrat e Punësimit kryejnë regjistrimin e personave të papunë në bazë të deklaramit të personit të papunë.

5. Regjistri i të papunëve përfshin:

5.1. Të dhënat personale;

5.2. Të dhënat e edukimit dhe trajnimit;

5.3. Të përvojës së punës;

5.4. Interesimit profesional,

5.5. Çdo informacion tjetër që është drejtpërdrejtë i lidhur me ndërmjetësimin e punëkërkuarit.

### **Amendamenti 10**

Në nenin 5, paragrafin 5, në fund të paragrafit fshihet fjalia „që siguron mbrojtjen e këtyre të dhënave dhe respektin për privatësinë personale të të papunëve të regjistruar”.

### **Amendamenti 11**

Në nenin 6, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Çdo punëkërkuar, ka të drejtë të regjistrohet në sistemin e shërbimeve online të Zyrës së Punësimit për të marrë shërbimet për ndërmjetësim në punësim.

### **Amendamenti 12**

Në nenin 7, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Çdo punëdhënës i cili i plotëson kushtet ligjore ka të drejtë të regjistrohet në Zyrën e Punësimit për të marrë shërbimet për ndërmjetësim në punësim.

### **Amendamenti 13**

Në nenin 7, paragrafi 3, nën-paragrafin 3.1. fjala „Emërtimi“ zëvendësohet me „Emri i biznesit” dhe në nën-paragrafin 3.2. shtohet „/ fiskal”.

### **Amendamenti 14**

Titulli i nenit 8, riformulohet si vijon „Ofrimi i shërbimeve për të papunët e regjistruar“

### **Amendamenti 15**

Në nenin 8 , nën-paragrafi 1.1. fjalia „ mbi situatën në“ zëvendësohet me lidhëzën „për“ dhe në nën-paragrafin 1.2. lidhëza „ mbi “ zëvendësohet me „ për”.

### **Amendamenti 16**

Në nenin 8, nën-paragrafi 1.12. riformulohet si vijon „Masa tjera që kanë të bëjnë me shërbimet e punësimit”.

### **Amendamenti 17**

Në nenin 9, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Nxënësit dhe studentët e rregullt si dhe personat nga mosha pesëmbëdhjetë (15) deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeçare që marrin shërbime nga Zyra e Punësimit, nuk do të jenë të regjistruar si të papunësuar.

### **Amendamenti 18**

Në nenin 12, nën-paragrafi 1.7 . riformulohet si vijon ,, Masa tjera që kanë të bëjnë me tregun e punës”.

### **Amendamenti 19**

Në nenin 16, paragrafi 2, në fund të paragrafit shtohet fjala,, ose elektronike”.

### **Amendamenti 20**

Në nenin 17, paragrafi 1, nën - paragrafi 1.5, nën - paragrafi 1.6. dhe nën - paragrafi 1.7. riformulohen si vijon:

1.5. Refuzon ndërmjetësimin e ofruar për punësim të përshtatshëm dy (2) herë;

1.6. Refuzon të hyjë në ndonjë mase aktive dy (2) herë apo e ndërpret pa arsye;

1.7. Refuzon të kërkoj punë në mënyrë aktive në tregun e punës.

### **Amendamenti 21**

Neni 23 riformulohet si vijon:

#### **Neni 23 Shfuqizimi i akteve**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr. 04/L-83 për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarave dhe punëkërkuessve.

2. Deri në nxjerrjen e akteve nën ligjore, brenda afatit të paraparë me këtë ligj, mbetet në fuqi Rregullorja Nr. 01/2012, për Programet Aktive të Tregut të Punës, dhe të gjitha aktet nënligjore që nuk janë në kundërshtim me këtë ligj.

#### **4.Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;**

**Kryetarja**, vazhdojmë me piken e katërt, para jush keni propozim amendamentet e grupit punues për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara të cilin po ashtu e falënderojmë për punën që ka bërë për këtë projektligj. Vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin e amendamenteve një nga një dhe në fund i miratojmë amendamentet komplet dhe i procedojmë me tej. Atëherë në mungese të kryetares së grupit punues znj. Njomza Emini, e cila tash ka kaluar në komisionin për Integritet Evropian, unë do ti prezantoj propozim amendamentet te cilat do ti votojmë.

**Komisioni**, pas prezantimit dhe diskutimit miratoj amendamentet një nga një, gjithë deputetet njëzëri miratuan raportin me amendamentet, komisioni nxori këtë:

#### **Përfundim**

Të procedohet me tej për shqyrtim në katër komisionet e përhershme raporti me amendamentet e miratuara për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

*Amendamentet e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, të miratuara në komision:*

## **Amendamenti 1**

Në nenin 2 të Projektligjit, paragrafin 1. riformulohet si vijon:

1. Shprehjet e përdorura në këtë Ligj, kanë këtë kuptim:

1.1. **Aftësia e kufizuar** - kufizim në qasje dhe aktivitete të zakonshme në jetën e përditshme të një personi, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, intelektuale ose mendore, që e pengojnë atë për pjesëmarrje në aktivitete të zakonshme ditore;

1.2. **Personat me aftësi të kufizuara** - personat që kanë dëmtime fizike, shqisore, intelektuale ose mendore afatgjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët;

1.3. **Kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, si pasojë e dëmtimit** - Invalidin e luftës, invalidin civil të luftës, invalidin e punës, personi i lindur me dëmtime fizike, shqisore, intelektuale ose mendore, dhe personi i cili si shkak i fatkeqësisë apo sëmundjes ka aftësi të kufizuar fizike, shqisore, intelektuale ose mendore;

1.4. **Komisioni Mediko-Social** - ekipe të përbërë prej ekspertësh mjekësor dhe ekspert të lëmive të tjera, i themeluar nga institucioni përkatës, me qëllim të konstatimit dhe vlerësimit të shkallës së aftësisë së kufizuar të një personi;

1.5. **Aftësimi dhe riaftësimi profesional** - të gjitha aktivitetet që synojnë të sigurojnë njohuri, shkathtësi të reja për punë efektive brenda profesionit që e ka kryer edhe më parë, apo për një profesion tjetër që personi me aftësi të kufizuara mund t'a kryejë me sukses;

1.6. **Përshtatshmëria e mjedisit** - masat e ndërmarra me qëllim të sigurimit të një mjedisi pa barriera të natyrave të ndryshme për sigurim të qasjes së përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara;

1.7. **Mjetet ndihmëse** - mjete të cilat i përdorin personat me aftësi të kufizuara, me qëllim të tejkalimit të pengesave të cilat e kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të zakonshme;

1.8. **Punë e përshtatshme** - punën të cilën e kryen personi me aftësi të kufizuara në përputhje me mundësitë e tij fizike, shqisore, intelektuale ose mendore si dhe me kualifikimin përkatës të fituar gjatë shkollimit të rregullt apo specifik, apo aftësimin dhe riaftësimin profesional;

1.9. **Trajneri** – profesionist i certifikuar, i cili ka mandat nga Qendra për Aftësim Profesional – QAP, që të organizoj procesin teorik dhe praktik të aftësimin dhe riaftësimin

profesional të kandidatëve të përfshirë në trajnim, t'i vlerësoj kandidatët për njohurit dhe shkathtësitë e arritura gjatë trajnimit;

1.10. **Edukimi specifik** - proces arsimor i aprovuar nga organet kompetente arsimore për plotësimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara;

1.11. **Asistenti** - person i domosdoshëm pa të cilin personi me aftësi të kufizuar nuk mund të aftësohet apo të riaftësohet për punë, ose të krijojë marrëdhënie pune;

1.12. **Punëtorja mbrojtëse** - ndërmarrje që themelohet me qëllim të ofrimit të punës dhe të punësimit të përshtatshëm, në vendin dhe hapësirën me pajisje përkatëse për personat me aftësi të kufizuara;

1.13. **Qendra punuese** - vend punishte e specializuar që punëson persona me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të punësohen apo ta mbajnë punën, sipas kushteve të përgjithshme, dhe të veçanta në punëtorinë mbrojtëse;

1.14. **MPMS** - Ministrinë përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale;

1.15. **APRK** - Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës;

1.16. **QAP** - Qendrat e Aftësimit Profesional të themeluara nga MPMS-ja që ofrojnë shërbime për aftësim, riaftësim dhe kualifikim të punëkërkuesve, me qëllim të rritjes së mundësive për punësim produktiv dhe vetëpunësim në harmoni me kërkesat e tregut të punës;

1.17. **ZP** - Zyrat e Punësimit.

## **Amendamenti 2**

Në nenin 4, të Projektligjit „ neni 5, 5A dhe 5B ‘ ’ zëvendësohen me „ neni 6, 6A dhe 6B”.

## **Amendamenti 3**

Në nenin 6, të projektligjit, paragrafi 2 riformulohet si vijon:

2. Në kushte të veçanta, personat me aftësi të kufizuara, mund të punësohen në Punëtorinë Mbrojtëse, Qendrat Punuese dhe në punë të tjera, në bazë të aftësive të punës dhe sipas kushteve të përgjithshme mund të punësohen në tregun e hapur të punës ose ta mbajnë punën e vet.

## **Amendamenti 4**

Në nenin 10 të Projektligjit, në fund të paragrafit 1.5. A shtohet fjalia „, dhe asistenti në raste të nevojshme”.

## **Amendamenti 5**

Neni 11 i Projektligjit, riformulohet si vijon:

Në nenin 18 të ligjit bazik, në fund të paragrafit 1, fjalia „ligjeve tatimore dhe doganore në fuqi” zëvendësohet me „një akt nënligjor të nxjerr nga Qeveria e Kosovës”, dhe paragrafi 2 fshihet nga teksti i ligjit.

## **5. Të ndryshme;**

**Kryetarja**, a ka dikush diçka të kjo pikë ?

Ne i kemi edhe dy projektligje në procedurë pra ende nuk e kemi përfunduar jemi në shqyrtim të projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent.

Po ashtu grupi punues për shqyrtimin e projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 / L - 054, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të ushtrisë çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, është duke punuar.

Ne po ashtu kemi miratuar planin e veprimit për monitorimin e Ligjit të Shëndetësisë, ku shumë shpejt do të vazhdojmë me monitorime këtij ligji.

**Kryetarja** – a ka dikush diçka tjetër Jo. Atëherë e mbyllim mbledhjen. Ju falënderoj për kontributin tuaj!

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetarja e Komisionit,**

---

**Flora BROVINA**